



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Unit	02
Nr Prot. Prot No	05-3687
Nr. faqeve No. pages	-44-
Data: Datum	08,06,2018
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH**  
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Ured Generalnog Sekretara/ Office of the Secretary General

<b>DATË/A:</b>	07/06/2018
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Dr Naim Bardiqi , UD Sekretar i Përgjithshëm
<b>CC:</b>	Z Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Mentor Sadiku- Udhëheqësi i departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Miratimi i Planit të Integritetit Institucional të MSh 2018-2020.

I nderuar Z Bardiqi,

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur për miratim Planin e Integritetit Institucional të Ministrisë së Shëndetësisë 2018 -2020.

Me respekt,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Shëndetësisë/Minsitarstvo Zdravstva Ministry of Health

*Plani i integritetit institucional*  
*Ministria e Shëndetësisë*  
*2018-2020*

## *Përmbajtja*

Shkurtesat .....	3
Hyrje.....	4
Terminologjia dhe përkufizimet.....	5
Metodologjia.....	5
Struktura dhe përmbajtja.....	6
Plani i Integritetit.....	6
Rezultatet dhe efektet e pritura.....	8
Pse sektori i shëndetësisë është i ndjeshëm ndaj korrupsionit.....	10
Përkushtimi ndaj integritetit.....	11
Objektivat Strategjike.....	12
Objektivi Strategjik I.....	13
Objektivi Strategjik II.....	15
Objektivi Strategjik III.....	21
Objektivi Strategjik IV.....	26
Plani i Veprimit.....	27

### *Tabela e shkurtesave*

OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
UNDP	Organizata për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara
AFSH	Agjencioni për Financim Shëndetësor
AKPM	Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale
FSSH	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
TQM	Kualiteti Total i Menaxhimit
IKAP	Instituti të Administratës Publike të Kosovës
JICA	Agjencioni Japonez për Bashkëpunim
SISH	Sistemi i Informimit Shëndetësor
OJQ	Organizatë jo qeveritare
SSSH2017-2021	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021
ISH	Institucione Shëndetësore
DIEKP	Departamenti për Integritet Evropian koordinim të Politikave
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të përbashkëta
DZHSSH	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor
DSHSH	Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore
ZSP	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
FSSH	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
SHKSUK	Shërbimin Klinik Spitalor Universitar të Kosovës

## *Hyrje*

Integriteti gjithnjë e më shumë njihet si një dimension thelbësor i qeverisjes demokratike. Sikurse që është parashtruar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) qeverisja demokratike në sektorin e shëndetësisë, konsiderohet të jetë gurthemel për forcimin e sistemit shëndetësor. Gjatë këtyre viteve Ministria e Shëndetësisë në Kosovë (në tekstin e mëtejme, MSH) përmes politikave dhe masave të saja ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe qasjes në sistemin shëndetësor me qëllim të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të popullatës. Raportet e mëhershme vendore dhe ndërkombëtare kanë treguar se qytetaret e Republikës së Kosovës janë shumë pak të kënaqur me shërbimet shëndetësore. Këto raporte kanë treguar që korrupsioni është shumë i pranishëm dhe paraqet sfidë serioze për shërbimet e kujdesit shëndetësor. Megjithatë, konkluzionet nga raportet e mëhershme janë bërë pa ndonjë analizë të thelluar. Aktualisht, është e qartë që ka nevojë për politika që do të përmirësonin cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore dhe do të ulnin nivelin e korrupsionit<sup>1</sup>

Megjithatë Publikimi i fundit nga UNDP 2013 tregon që ka një kënaqëshmëri të lartë të pacientëve me shërbimet e kujdesit shëndetësor në Kosovë, për faktin se më shumë se 70% e tyre ishin *të kënaqur ose shumë të kënaqur* me shërbimet, stafin dhe mbështetjen që ata kanë marrë në institucionet e kujdesit shëndetësor. Në ndërkohë, korrupsioni shfaqet në nivele më të ulëta nga që është raportuar në studimet tjera, me vetëm 4% e të anketuarve të kushtëzuar në vizitën e tyre të fundit.<sup>2</sup>

Megjithatë, në Kosovë problemet dhe aferat e korrupsionit në shëndetësi seriozisht po e sfidojnë efikasitetin e të gjitha masave të reformës andaj nevojitet një plan për ruajtjen e integritetit institucional të Ministrisë së Shëndetësisë.

---

<sup>1</sup> Dokument Veprimi mbi Shëndetësinë në Kosovë *Kënaqshmëria me shërbimet shëndetësore dhe perceptimet mbi praninë e korrupsionit* Tetor, 2013 UNDP

<sup>2</sup> Po aty,

### ***Terminologjia dhe përkufizimet***

*“Integriteti”* është performanca e pritur e organizatave dhe përgjegjësia e individëve për parandalimin dhe eliminimin e rrezikut në raport me ligjin, kodin e etikës dhe praktikave të punës. Integriteti paraqet një platformë më të gjerë se kundër korrupsionit ku përfshinë një grumbull veprimesh, të sjelljeve dhe mekanizmave të brendshme të një organizate e cila mbështetë sjellje dhe praktika punuese të ndershme dhe etike. Integriteti duhet të ketë koordinim social dhe profesional si dhe bashkëpunim në mes të njerëzve, në përputhje me vlera dhe standarde të pranuar.

*“Procesi i menaxhmentit të rrezikut të integritetit”* është një aplikim sistematik i politikave, procedurave dhe praktikave të menaxhmentit ndaj aktiviteteve të komunikimit, konsultimit, vendosjes së kontekstit, dhe identifikimit, analizimit, vlerësimit, ballafaqimit, monitorimit dhe rishikimit të rrezikut të integritetit.

*“Planifikimi i integritetit”* proces i përgjithshëm i vlerësimit të rrezikut të integritetit dhe zhvillimit të planit të integritetit të bazuar në rrezik në përputhje me objektivat e integritetit/përkushtimet dhe caqet e integritetit.

*“Vlerësimi i rrezikut të integritetit”* është proces i përgjithshëm i identifikimit, analizës dhe vlerësimit të rrezikut të integritetit.

### ***Metodologjia***

Për hartimin e Planit të Integritetit, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarr këto veprime:

- Ka shqyrtuar Politikën Strategjike dhe kornizën ligjore,
- Ka shqyrtuar analizat për sektorin e shëndetësisë (Dokument Veprimi mbi Shëndetësinë në Kosovë *Kënaqshmëria me shërbimet shëndetësore dhe perceptimet mbi praninë e korrupsionit* Tetor, 2013 UNDP)
- Ka shqyrtuar raportet e monitorimit dhe zbatimit të legjislacionit
- Ka analizuar kënaqshmerinë e pacientëve dhe qytetarëve rreth perceptimit të korrupsionit nga studimet e sektorit të shëndetësisë, duke përfshirë edhe studimet/raportet nga organizatat ndërkombëtare

- Ka zhvilluar pyetësonin me stafin e Ministrisë së Shëndetësisë për integritetin institucional
- Ka mbajtur punëtori ku janë parashtruar idetë dhe konsultime publike dhe teknika debatuese për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun për integritet ku janë paraqitur masat preventive;
- Ka përdorë dokumente që kanë të bëjnë me zhvillimin e integritetit, udhëzimet e OBSH, UNDP, përmbledhjet e praktikave më të mira të integritetit si referenca për mbështetje rekomandimeve.

### *Struktura dhe përmbajtja*

Plani i integritetit përmban hyrjen që shpjegon sfondin, fushëveprimin, qëllimin, objektivat dhe metodologjinë për të zhvilluar. Aktivitetet orientohen në drejtim të arritjes së objektivave strategjike dhe përfshijnë fushat të cilat kanë për qëllim forcimin e mbrojtjes së integritetit në MSH duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut të integritetit, në përvojat dhe praktikatat më të mira. Plani ofron një arsyetim të shkurtër për drejtimet e aktiviteteve të planifikuara, të mbështetura nga masat e parapara për të udhëzuar zbatimin e tij.

Plani i veprimit - paraqet në detaje të gjitha aktivitetet të cilat do të ndërmerren për të arritur objektivat e planifikuara, gjithashtu edhe afatet relevante dhe përgjegjësitë e MSH për zbatim si dhe koston e zbatimit. Gjithashtu, Plani ka përcaktuar indikatorët e suksesit për secilën masë, dhe ato mbështeten nga burimet e nevojshme financiare për zbatim si dhe bartësit e burimeve financiare.

### *Plani i integritetit*

Plani i integritetit është një dokument strategjik dhe operacional që bazohet në rezultatet e planifikimit të integritetit dhe të procesit të vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë brenda MSH. Procesi bazohet në identifikimin e shkeljeve të mundshëm në pozitat e ndjeshme si dhe vlerësimi i tyre duke marrë parasysh (1) dëmtimet materiale dhe jo materiale që mund të shkaktohen nga shkeljet potenciale, dhe (2) rezistencën organizative të praktikuar me rregullore, procedura, kode dhe praktika relevante si dhe me përfshirjen e stafit si pjesë aktive e këtij procesi.

### Fushëveprimi, qëllimi dhe objektivat

Plani është mjet plotësues i politikave dhe kornizës ligjore që i dyfishon masat që kanë për qëllim ruajtjen e integriteti institucional në Ministrinë e Shëndetësisë.

Plani po ashtu ka për qëllim arritjen e objektivave të Ministrisë së Shëndetësisë në inkurajimin e menaxhmentit që të adresoj rrezikun e integritetit ku parashihet:

- Të minimizoj humbjet nga korrupsioni dhe shkeljet e integritetit
- Zvogëlojë mundësitë për korrupsion dhe përmirësoj rezistencën e organizatës ndaj korrupsionit
- Të siguroj përputhjen në mes kërkesave me normat ligjore dhe procedurale
- Të siguroj përputhjen me normat dhe standardet ndërkombëtare
- Të krijoj dhe forcoj kapacitetet e të gjithë stafit për një luftë efikase kundër korrupsionit duke krijuar ndërgjegjshmëri në të gjitha nivelet
- Të krijoj mekanizmat për zbatimin dhe monitorimit të Planit të integritetit;
- Të rritë transparencën dhe të përgjigjet në kërkesat në lidhje me performancat e integritetit të sektorit publik.

Derisa qëllimi primar i MSH është të përmirësoj rezistencën e organizatës ndaj shkeljeve të integritetit brenda saj, plani parasheh një perspektivë më të gjerë që të arrij në mënyrë indirekte edhe te pjesëmarrësit tjerë në sektorin e shëndetësisë përmes forcimit të kapaciteteve, rritjes së vetëdijes, komunikuese dhe konsultuese.

MSH e vetëdijshme për rolin e rëndësishëm që ka si mekanizmi kryesor në sektorin e shëndetësisë, me potencial të gjerë që të influencoj ndërrime pozitive me nxitjen e planit të integritetit dhe të menaxhmentit, ka tendencë që këtë plan ta përdor si një mekanizëm që të ndiqet edhe nga të tjerët. Përpjekja në zbatimin e planit të integritetit do të inkurajoj dhe motivoj edhe njësitë e sektorëve tjerë publike, përfshirë edhe Shërbimin Klinik Spitalor Universitar të Kosovës (SHKSUK) si dhe institucione shëndetësore relevante që të ndërmarrin masat e nevojshme që ti përmirësojnë dukshëm rregullat dhe praktikatat e tyre kundër korrupsion, dhe kështu të inkurajoj rezultatet më të mira në shëndetësi.

### *Rezultatet dhe efektet e pritura*

Ministria e Shëndetësisë do të zhvilloj veprime konkrete për të siguruar rezultate më të mira përmes efikasitetit, transparencës dhe etikës. Qëllimi i Planit është që të njihet si shembull edhe në sektorin privat dhe joqeveritar, i perceptuar si mekanizëm efikas i reduktimit të kostos njerëzore dhe ekonomike me qëllim të përmirësimit të vazhdueshme organizativ, që do ta rritë reputacionin dhe besueshmërinë.

### *Periudha e Zbatimit*

Në përputhje me strategjinë Kundër korrupsion të Kosovës dhe Planin e veprimit, ky Plan i integritetit do të zbatohet gjatë periudhës 2018-2020, që korrespondon me ciklin strategjik të ardhshëm kundër korrupsionit dhe me Planin e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 (SSSH 2017-2021)

### *Mbështetësit e Zbatimit*

Është me rëndësi të punohet në zbatimin e këtij plani edhe me sektorët tjerë. Korrupsioni nuk mund të kufizohet në sektorin e shëndetësisë pa përfshirjen e sektorëve tjerë kritik, sikurse që janë infrastruktura dhe financat. Prandaj, ky plan e thekson rëndësinë e qasjes gjithëpërfshirëse që ekzaminon çështjet e integritetit nëpër pjesë të ndryshme të administratës publike. Gjatë implementimit të masave të saja, MSH do të punoj që të ketë mbështetjen e të gjithë pjesëmarrësve në kundër korrupsion, duke përfshirë pos tjerëve edhe Zyrën e kryeministrit, Agjencinë kundër korrupsionit, Ministrinë e Financave, Shoqërinë civile, përfaqësuesit e sektorëve privat etj.

### *Buxheti për zbatimin e Planit*

Duke marrë parasysh faktin se numri më i madh i aktiviteteve në kuadër të Planit për integritet institucional janë aktivitete që hyjnë në kuadër të termave të referencave dhe përshkrimeve të punës së zyrtarëve në Ministrinë e Shëndetësisë, atëherë Plani do të përmbaj vetëm bartësin e kostos së buxhetit për veprime. Gjithashtu në disa aktivitete kemi marrë zotime nga komuniteti i donatorëve për zbatimin e planit.

### *Zbatimi i planit*

Plani i integritetit nuk është dokument statik, por një dokument monitorimi me një format të planifikues, duke u shqyrtuar kohë pas kohe dhe duke u përditësuar në përputhje me kornizën ligjore, me zhvillimet relevante institucionale, procedurale dhe të personelit brenda dhe jashtë institucionit. Vazhdimësia e monitorimit të implementimit të Planit të integritetit është me rëndësi për të siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat trajtuese të jenë efikase edhe nga forma edhe nga veprimi dhe se procedurat janë kuptuar dhe plani i integritetit po zbatohet. Monitorimi do të përcakton se a kanë qenë efikase masat e adoptuara trajtuese ndaj rrezikut, po ashtu plani do të mundësoj vërejtjen e ndryshimeve në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm, duke përfshirë ndryshimet ndaj vetë rrezikut që do të kërkonin rishikimin e trajtimeve të rrezikut si dhe çka duhet të mësohet për planifikim të mëtejshëm. Përgjegjësitë për monitorim të rregullt të Planit do të ketë divizioni për monitorim dhe evaluim në kuadër të Departament për Zhvillim Strategjik Shëndetësor.

### *Raportimi i Zbatimit*

Raportimi i rregullt është vendimtar për tu siguruar se zbatimi i planit është duke shkuar sipas afateve të përcaktuara dhe rezultatet e planifikuara janë arritur. Divizioni për monitorim dhe evaluim do të jetë përgjegjës për të raportuar në mënyrë të rregullt në zyrën e Sekretarit të përgjithshëm dhe në kabinetin e ministrit. Raportimet do të bëhen në periudhë gjashtëmuajore. Raportimi i mundëson Ministrisë që të ndërmarr masa adekuate përmirësuese dhe parandaluese në rast kur zbatimi i disa masave të caktuara has në vështirësi dhe shtyrje.

### *Pse është sektori i shëndetësisë i ndjeshëm ndaj korrupsionit*

Sektori i shëndetësisë në të gjithë botën është i njohur të jetë i prirë për korrupsion për shkak të përfshirjes së nivelit të lartë të kompleksitetit dhe të rrezikut të këtij kompleksiteti. Pasiguria, asimetria e informatave dhe një numër i madh i personave të përfshirë në këto veprime krijojnë mundësi sistematike për korrupsion ku është shumë vështirë të arrihen transparenca dhe përgjegjësia. Pasiguria ndryshe nga shërbimet tjera, te shërbimet mjekësore pasqyrojnë një pasiguri të dukshme në lidhje me rezultatet shëndetësore.

Asimetria e informatave dhe vet informatat nuk ndahen në mënyrë të barabartë me të gjithë akterët e shëndetësisë, dhe kjo rezulton në mos efikasitet të dukshëm dhe mundësi të zhvillimit të korrupsionit. Për shembull, kompanitë farmaceutike i njohin më së miri prodhimet e tyre në krahasim me ofruesit e shërbimeve të cilët i prokurojnë ato apo mjekët të cilët ju japin pacientëve. Kjo i lenë pacientët në situata të pavolitshme po qe se furnizuesit vendosin të keqpërdorin pozitën e tyre. As pacientët, as organet mbikëqyrëse nuk mund ti mbikëqyrin plotësisht vendimet që i marrin vepruesit e ndryshëm, dhe ti bëjnë përgjegjës ata.

Një numër i madh i personave të përfshirë nga të gjitha anët e rrisin shumëfish rrezikun nga korrupsioni, përfshirë organet qeveritare, ofruesit e shërbimeve mjekësore si spitalet, mjekët, farmacistët, pacientët, dhe furnizuesit, kompanitë farmaceutike, kompanitë e ndërtimit, etj.

Faktorët e lartpërmendur bashkërisht shpërndajnë informata akterëve të ndryshëm si paguesve, ofruesve, pacientëve dhe furnizuesve në ato mënyra që e bëjnë sistemin të ndjeshëm ndaj korrupsionit gjë që e pengon transparencën dhe përgjegjësinë. Pacientët në përgjithësi kanë pozicion dhe fuqi më të dobët që disiplinojnë vepruesit tjerë duke kritikuar apo duke zgjedhur kompani tjetër shëndetësore. Pos kësaj, është vështirë të identifikohen apo të dënohen veprimet korruptuese, pasi që abuzimet aktuale mund të fshihen me qëllim prapa jo efikasitetit.

### *Përkushtimi ndaj Integritetit*

Ballafaqimi efektiv me korrupsionin në sistemin tonë shëndetësor është me rëndësi jetike për të arritur rezultate më të larta në shëndetësi me qëllim që të mundësoj shërbime me të mira për të gjithë qytetaret në Republikën e Kosovës. Intervenimet efektive për tu ballafaquar me këto dobësi mund të sjellin deri te arritja e rezultateve me të mira në shëndetësi.

Në Kosovë autoriteti më i lartë, Ministria e Shëndetësisë, ka përgjegjësinë kryesore për të krijuar politika dhe për të bërë monitorimin e zbatimit të këtyre politikave që do të ndikonte edhe në luftë kundër korrupsionit. Zvogëlimi i rrezikut nga korrupsioni dhe rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike padyshim do të jep rezultate më të mira në shëndetësi. Duke marrë parasysh faktin se korrupsioni eventual në sektorin e shëndetësisë do të shkatërronte legjitimitetin dhe besimin publik të institucioneve qeveritare, intervenimet e suksesshme kundër korrupsionit të ndërmarra nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë do të paraqesin përkushtim të

qeverisë dhe do të forcojnë transparencën, dhe do të rrisin pjesëmarrjen e të gjithë aktereve në sektorin e shëndetësisë në përgjithësi.

Për tu ballafaquar me këto sfida, MSH do të ndërmerri masa efikase dhe të vendosura kundër korrupsionit në të gjitha fushat në kompetencë dhe brenda mandatit të saj. Ky plan i integritetit i kodifikon caqet, drejtimet e veprimeve dhe masat që duhet të ndërmerren nga MSH në të ardhmen që edhe më tej ti përmirësoj politikat dhe praktikatat e saja preventive kundër korruptuese dhe të forcojë rezistencën e saj organizative kundër korrupsionit. Për shkak të karakterit të saj gjithëpërfshirës të sistemit menaxhues të zbatuar në MSH, plani i integritetit nuk mundet të perceptohet si një dokument i veçuar, por duhet të shihet si një pjesë e rëndësishme e procesit planifikues të zhvillimit. Gjithashtu do të zbatohet edhe aktivitetet tjera në mbështetje të konventës regionale kundër korrupsionit, sidomos të qeverisjes demokratike duke forcuar iniciativat e OBSH (WHO). Ky plan do të në përpjekjet e MSH në drejtim të arritjes së performancës më të mirë të integritetit përmes formulimit të një porosie të qartë për anti korrupsion, duke forcuar rezistencën organizative përmes kontrolleve të bazuara në rrezik, duke përmirësuar aspektet e integritetit në lëmit kyçe të mbikëqyrjes dhe ti bëjë të ndjeshme praktikatat e konsultimit dhe komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm që kanë të bëjnë me rrezikun për integritet. Planin e integritetit të MSH ka potencial që gjithashtu të influencoj pozitivisht agjendën kundër korrupsion në nën-segmente specifike të sektorit të shëndetësisë në përgjithësi.

Ky plan do të paraqet bindjen e plotë në integritet të deklaruar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, që është e përcaktuar që të mbaj qëndrim pro aktiv ndaj shkeljeve potenciale të integritetit dhe të siguroj se suksesi i masave të sipërme reformuese nuk është viktimë i kërcënimeve ndaj integritetit që bëhet përmes masave abuzive të grupeve të fuqishme të interesit, apo abuzimeve dhe rezistenca nga brenda. Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për krijimin e elementeve kyçe të kornizës normative dhe operacionale të integritetit. Vetëm integriteti i bazuar në rrezik do të lejojë rezultate të qëndrueshme.

## *Objektivat Strategjike*

Reforma në shëndetësi bazohet në rritjen e transparencës dhe llogaridhënien e ofruesve të kujdesit shëndetësor përmes themelimit të strukturave dhe agjensioneve të reja. Reformat si tërësi përfshijnë:

- ndarjen e çështjeve politike nga ato profesionale përmes Odave të profesionistëve shëndetësorë të cilat do të sigurojnë përmirësimin e profesionalizimit dhe unifikimin e standardeve në institucionet publike dhe private;
- krijimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore për të siguruar qasjen në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët;
- ndarjen e qartë të rolit të ofruesit të shërbimeve përmes Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës nga roli i blerësit të shërbimeve – Fondit të Sigurimeve shëndetësore
- fuqizimin e qeverisjes dhe menaxhimit në sektorin shëndetësor përmes rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Të gjitha këto zhvillime ofrojnë bazë të shëndoshë për avancimin e agjendës së menaxhmentit të integritetit. Duke ec para, MSH do të fuqizoj reformat për të përmirësuar integritetin dhe të parandaloj korrupsionin duke u fokusuar në këto fusha më të rëndësishme:

**Rezistencën** e forcuar të organizatës ndaj shkeljeve të integritetit në MSH përmes kornizës ligjore dhe politikave për integritetin, integrimin dhe rritjen e efikasitetit, efektshmërisë dhe transparencës në të gjitha funksionet e MSh, duke e integruar menaxhmentin e rrezikut të integritetit si element thelbësor i përgjegjësisë së menaxhmentit, rezistencën e shtuar ndaj shkeljeve të integritetit përmes forcimit të kontrollit të integritetit operacional në fushat kyçe të mbikëqyrjes dhe nën-fushave që janë të ndjeshme ndaj korrupsionit

**Ndërtimin dhe forcimin e burimeve** të brendshme për zbatimin e objektivave të integritetit duke siguruar kapacitetet adekuate. Kjo praktikë në mënyrë indirekte të ndikoj në institucionet shëndetësore në sektorin publik që ti mundësohet stafit ti kuptojnë çështjet e integritetit, ti aplikojnë rregullat relevante të mbikëqyrjes së zbatimit dhe të ndërmarrin veprime të nevojshme përmirësuese dhe parandaluese. Mbështetjen e kulturës së integritetit në të gjithë sektorin e

shëndetësisë në Kosovë me praktika të mira por edhe duke vlerësuar zbatimin dhe ndikimin e institucioneve të integritetit dhe masat për mësim të vazhdueshëm të politikave dhe përshtatjen e tyre.

Roli i MSh si autoritet kyç në zbatimin këtij Plani kundër korrupsion do të jetë vendimtar. Në këtë kontekst, përpos masave institucionale që duhet të ndërmerren vetëm nga MSh, për të përmirësuar rezistencën e vet organizacionale ndaj shkeljeve të integritetit, Plani parasheh që MSh të ndërmerr edhe masa të cilat kanë për cak përfshirjen e një varg të gjerë të pjesëmarrësve si institucionet shëndetësore publike, dhe Fondin e sigurimit shëndetësor. Për të arritur qëllimet e mësipërme, janë paraparë këto masa.

***Objektiva strategjike I: Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit përmes zbatimit të kornizës strategjike relevante mbi integritetin***

Investimet që bëhen në sektorin e shëndetësisë mund të mos kenë rolin dhe ndikimin e dëshiruar nëse në investimet shëndetësore nuk ndërtohen mekanizmat e brendshme për të adresuar rreziqet korruptive. Masat parandaluese pro-aktive mund ti mbrojnë investimet e bëra. Praktikrat e intervenimeve nga Ministria e Shëndetësisë bëhen pas marrjes së rekomandimeve nga mekanizmat e kontrollit të jashtëm dhe të brendshëm siç është rasti me rekomandimet e auditorit. Mbikëqyrja dhe raportimi i rregullt në Ministrinë e Shëndetësisë për mospërputhjet në procedura dhe standarde dhe mungesat në zbatim janë mekanizma kyç për të adresuar problemet potenciale korruptive. Për këto qëllime, janë paraparë këto veprime:

***1.1. Zhvillimi i mëtejme dhe përmirësimi i politikave kundër korrupsion dhe integritet***

- Të integrohen pikat potenciale kundër korrupsionit në *Planin zhvillimor institucional* të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Të sigurohet se stafi është i njoftuar me mekanizmat mbikëqyrëse në Ministri;
- Të caktohen përgjegjësitë për të mbikëqyrë dhe raportuar zbatimin e Planit të integritetit;

- Të integrohet qasja kundër korrupsionit në Strategjinë/Planin e Veprimit të SSSH 2017-2021;
- Të inkurajohet zhvillimi i përgjegjësisë, transparencës përmes komunikimit brenda Ministrisë;
- Ministria e Shëndetësisë të nxitë një qasje gjithëpërfshirëse kundër korrupsion duke përdorur mandatin dhe rolin e vet duke promovuar dhe mundësuar zbatimin e planit të integritetit në tërë sektorin e shëndetësisë përmes veprimeve komunikuese, kampanjave të vetëdijesimit dhe ndihmën për ndërtimin e kapaciteteve dhe promovimin e praktikave të mira;
- Të zhvillohet qasja sistematike ndaj: mbikëqyrjes, duke vlerësuar dhe komunikuar rezultatet e zbatimit të masave të integritetit nga brenda, përfshirë edhe botime të raporteve për masat e integritetit si pjesë e raporteve vjetore të menaxhmentit;
- Të iniciohet monitorimi i jashtëm dhe mbikëqyrja e zbatimit të masave, përfshirë edhe ato nga qytetarët, OJQ-ve, etj. Të sigurohet se rezultatet janë në dispozicion për publikun;
- Të forcoj zbatimin e Kodit të etikës përmes komunikimit efektiv me gjithë stafin duke raportuar, shkeljet e supozuara të integritetit;
- Të forcoj rregullat dhe praktikatat në fushat kryesore të mbrojtjes së integritetit: Konflikti i interesit, deklarimet e pasurive, dhuratat;
- Të kryej vlerësimin e mos zbatimit të rregullave të brendshme në të gjitha fushat dhe të ndërmerren veprime adekuate për përmirësim;
- Të sigurohet që ndryshimet ligjore të zbatohen për të garantuar aplikimin e kuptueshëm të kornizës së re organizacionale dhe të minimizohen mundësitë për shkeljet e integritetit të cilat dalin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e paqarta;

## *Objektiva Strategjike II-Ngritja e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës së të gjitha funksioneve të MSh-së*

Ministria e Shëndetësisë sikur se sektorët tjerë qeveritare, ballafaqohet me shumë rreziqe për integritetin të gjeneruar nga faktorët e jashtëm dhe të brendshëm. Po që se nuk menaxhohet në mënyrë të duhur, rreziku i integritetit mund ndikoj në efikasitet dhe efektivitet të veprimeve të MSh dhe në uljen e besimit publik në ministrinë dhe qeverinë. Menaxhimi i rrezikut të integritetit, nga ana tjetër, mbështetë shërbimet publike efikase dhe transparente, përmirëson përgjegjësinë menaxheriale, mundëson mbikëqyrjen e kuptueshme të informuar dhe të kontrolluar, lejon intervenime ndaj caqeve ku rreziku është më i madh dhe dëmi më i lartë, dhe ndërton besimin në organizatë. Gjithashtu mbështetë shpërndarjen më të mirë të mjeteve dhe rezultateve.

Menaxhimi i rrezikut të integritetit duhet të krijohet si proces sistematik i strukturuar për të identifikuar, (ri)-vlerësuar dhe zvogëluar rrezikun operacional të integritetit. Stafi nga të gjitha nivelet dhe funksionet në MSh duhet të kuptoj, të njoh, dhe të shpërblehet për menaxhimin e rrezikut të integritetit gjatë aktiviteteve të tyre ditore në punë. Për të qenë efikas, menaxhimi i rrezikut të integritetit duhet të integrohet në sistemet tjera menaxhuese dhe të përqendrohet në vendimmarrje, planifikim, performanca dhe monitorim, duke përfshirë përmirësimet dhe parandalimin. Për të arritur qëllimet e mësipërme, janë paraparë këto masa.

### ***2.1. Forcimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së nivelit të lartë brenda MSH për të siguruar përgjegjësi dhe transparencë gjatë zbatimit të politikave***

- Të komunikohet Plani i integritetit të gjithë stafit, duke përfshirë shpërndarjen përgjegjëse për zbatim;
- Të caktohet personi/ komisioni me një mandat të posaçëm të këshilluesit të Integritetit/Komisioni i etikës;

- Të sigurohen kapacitet e duhura për menaxhim të integritetit dhe planifikim përmes veprimeve për forcim të kapacitetit (fokusim i posaçëm në menaxhmentin e lartë dhe atë të mesëm);
- Të sigurohet ri-vlerësimi periodik, i aktivitete të njëjse me funksione për të kontrolluar fushat me nivel të lartë të rrezikut;
- Të përcaktohen metodat më të përshtatshme për të arritur përmirësim real dhe të qëndrueshëm;
- Të kuptohen parametrat kyç të ambientit të brendshëm të organizatës (hulumtime nga stafi, pyetësorët mund të ndihmojnë për të mbledhë shënime dhe të ofrohen sugjerime.);
- Të forcon kapacitetet e tanishme për të përforcuar perspektivat e integritetit në aktivitetet e tyre;
- Të vlerësohen sistematikisht strategjitë dhe zbatimi, dhe të sigurohet raportimi relevant;

### *2.3. Monitorimi i sistemit menaxhues për të siguruar shërbime cilësore dhe rritje të transparencës*

- Të zbatoj praktika kualitative të menaxhmentit në MSH për ti identifikuar mundësitë për përmirësim të bazuara në zgjedhjen e instrumentit TQM (ISO 9001:2008 Kërkesat për sistem menaxhues kualitativ, Korniza e thjeshtë e vlerësimit);
- Të siguroj burimet e nevojshme dhe të merr parasysh implementimin progresiv të instrumenteve të zgjedhura (TQM);
- Të vendosen indikatorët e performancës të duhur për të gjitha proceset dhe të siguroj mbikëqyrjen e tyre të rregullt dhe raportimin;

- Të përdoren informatat e mbledhura nga shfrytëzuesit e shërbimeve si instrument për të përmirësuar performancat organizative dhe për të siguruar kënaqshmerinë e pacientëve ;

### ***2.3.1. Sigurimi i integritetit të Sistemit e Informimit shëndetësor (SISH) për të arritur shkallë më të lartë të pajtueshmërisë me praktikat e mira ekzistuese dhe standarde relevante, sidomos ISO 27001:***

- Të vendoset theksi i posaçëm në mbrojtjen e konfidencialitetit në informatat e klasifikuara si fshehtësi (rregullat dhe praktika), sikurse edhe në analizat e informatave që vijnë;
- Të kryhet vlerësimi i zbrazëtisë së informatave të sistemit informativ bazik shëndetësor në vend për t'i identifikuar mundësitë për të forcuar më tepër kontrollin operacional dhe të parandalohen shkeljet e integritetit;
- Të përcaktohen standarde që përcaktojnë kërkesat për vendosjen, zbatimin, operimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurimit të informatave të dokumentuara që do të ndihmoj në zgjedhjen e kontrolleve të sigurimit adekuat dhe proporcional për mbrojtjen e aseteve të informatave dhe do të rritë besueshmërinë organizacionale para pjesëmarrësve dhe të parandalon shkeljet e integritetit;

### ***2.4. Forcimi i integritetit nga menaxhmenti i burimeve njerëzore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në MSH***

- Të zbatohet plani zhvillimor i institucional;
- Të përmirësohet rezistenca e organizatës ndaj korrupsionit gjatë procesit të rekrutimit dhe zgjedhjes përmes forcimit (kodifikimit) të rregullave të brendshme për rekrutim;

- Të sigurohet përshkrimi i qartë i vendit të punës në përputhje me Rregullat e klasifikimit të vendeve të punës dhe rregulloret relevante për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- Të sigurohet komunikimi efikas të përshkrimit të vendeve të punës te të gjithë stafi;
- Të përmirësohet vlerësimi i personelit dhe menaxhmenti i performancës;
- Të mbikëqyren performancat në punë dhe të sigurohet se punët kryhen sipas planifikimeve;
- Të zhvillohen indikatorët që do të vlerësojnë cilësinë e punës;
- Të sigurohen politikat për përparimet në punë në bazë të meritave;
- Vazhdimisht të përmirësohet sistemi i shpërblimit si pjesë e menaxhimit të burimeve njerëzore në qeveri, në përputhje me kriteret objektive;
- Të krijohet sistem kualitativ për shpërblim dhe për motivim të stafit ;

***2.5. Të përmirësohet mbrojtja e integritetit për procesin e prokurimit publik në MSh, për të parandaluar jo efikasitetin, humbjet eventuale dhe keqpërdorimet.***

- Të rritet transparenca e procesit të prokurimit në të gjitha fazat e tij duke vendosur standardet minimale për transparencë në prokurimin publik në MSh;
- Të vendosen rregullat e brendshme-Rregullorja për prokurim, rregulla të thjeshta dhe të qarta në që mund të shihen vizualisht;
- Të paraqitet dhe mirëmbahet sistemi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punëtorët e prokurimit të MSh, duke u fokusuar te kontrolli operacional, për të parandaluar shkeljet e integritetit;
- Të përmirësohet transparenca në të gjitha fazat e prokurimit;

- Të merret parasysh integrimi i informatave të prokurimit si një burim nga të merren informatat për furnizuesit dhe qytetarët. Fazat e prokurimit ku transparenca sidomos ka të bëjë me shpallje të tenderëve, kriteret e zgjedhjeve, procesin e vlerësimit, vendimin për fituesin dhe arsyetimin, kushtet dhe afatet e kontratës dhe të gjitha ndryshimet e saj, implementimin e kontratës, mosmarrëveshjen dhe procedura për marrëveshje. Të rritet transparenca në fazën para-tenderuese të ciklit të prokurimit, për shembull përmes përgatitjes dhe publikimit të planeve të prokurimit/ofertave, nga MSh për të lejuar kontrollin dhe monitorimin;
- Të vendoset protokoll i qartë për të komunikuar me ofertuesit. Të krijohet një pikë kontakti e qartë për ofertuesit. Të lejohet vetëm një numër i vogël i zyrtarëve të kenë të drejtë me u marrë drejtpërdrejtë me ofertuesit;
- Të inkurajohen kompanitë që të certifikohen se ata pajtohen me të gjitha ligjet kundër mitos dhe të futet në kontratë kërkesat direkt për përkushtim ndaj kundër-korrupsionit sikurse që është kodi i sjelljes;
- Të zhvillohen indikatorët për performancë të prokurimit në nivelin e MSh për t'i ndihmuar zyrtarët dhe menaxherët e prokurimit publik të përmirësojnë performancën;

➤ ***Forcimi i mëtejshëm i kontrollit të brendshëm dhe funksionit të auditimit brenda MSH***

- Të vlerësohet efikasiteti i sistemit të brendshëm të auditimit të bazuar në procedurat e zhvilluara dhe indikatorët relevant;
- Të forcohen dhe shpërndahen kanalet e informatave të inteligjencës për të raportuar shkeljet e Kodit të sjelljes dhe rregullave relevante të integritetit;
- Të përmirësohet më tej sistemi komunikues në lidhje me rezultatet e inspektimit për të parandaluar në mënyrë efektive rastin ku deri te informatat mund të arrihet me vështirësi, të i pamundësohet departamenteve tjera t'i plotësojnë detyrat e tyre;

*2.6. Të forcohen mekanizmat e MSh për të mbrojtur dëshmitarët që tregojnë për shkelje si forcimin e procedurave të ankimit*

- Të zhvillohet një procedurë unike e brendshme për dëshmitarët të cilët tregojnë për shkelje si mënyrë për të raportuar për korrupsionin e vërejtur apo ndonjë dyshim në lidhje me veprimet e dyshimta;
- Të sigurohet se procedura është e komunikuar mirë dhe e kuptuar nga i tërë stafi;
- Të mbështetet paraqitja e kanaleve dhe procedurave të brendshme për të raportuar korrupsionin në institucionet shëndetësore;
- Të zhvillohet sistem i jashtëm i procedimit të ankesave/komplimenteve si instrument i menaxhmentit për të forcuar përgjegjësinë;
- Të sigurohet (një herë në vit) analiza e sugjerimeve dhe ankesave që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve dhe respektimin e standardeve për shërbimin e kryer;
- Të forcohen mekanizmat e brendshëm për ankesat kundër hierarkisë.

### *Objektivi strategjik III Forcimi i kontrolleve operative ndaj shkeljeve të integritetit në sektorin e shëndetësisë*

Sektori i shëndetësisë vendi ku bëhet blerja e barnave, pajisjeve mjekësore, dhe furnizimeve, me të drejtë është paraqitur si rreziku primar për korrupsion. Problemet me transparencën dhe kontrollet e dobëta në këtë fushë kanë ndikim të dukshëm në cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të kryera. MSh, duke qenë e vetëdijshme se këto fusha kanë nevojë për analiza të rrezikut specifik të sistemit, ka bërë përpjekje dhe po ballafaqohet me rreziqet serioze të korrupsionit që kanë të bëjnë me të. Ministria me përpjekjet e saja kundër korrupsionit duhet sistematikisht të integrohet në politikat e sektorit shëndetësor dhe anasjelltas. Korrupsioni si çështje publike nuk do të zhduket vetvetiu, prandaj nuk duhet të injorohet. Eksperiencat pozitive nga rajoni dhe bota, tregojnë se është e mundur të merresh me korrupsionin duke i ndërruar rrethanat të cilat e kanë lejuar të ndodhë atë. Për të arritur qëllimet e mësipërme, janë paraparë këto masa.

### *Hartimi dhe zbatimi i praktikave të mira qeverisëse*

- Të sigurohet që marrëveshjet me ofruesit e shërbimeve shëndetësore në sektorin e shëndetësisë, objektivat, rolet dhe përgjegjësitë të jenë qarta;
- Të mbështetet zhvillimi dhe zbatimi i kodeve të sjelljes për profesionistët shëndetësor;
- Të përmirësohet informimi shëndetësor për aktivitet/shërbimet e kryera;
- Të sigurohet sistemi i tanishëm funksional për të garantuar monitorimin të performancës së ofruesve të shërbimeve shëndetësore, në mënyrë adekuate siguroj procesin e mbledhjes së raporteve mujore të monitorimit nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore me përcaktim të qartë të përgjegjësisë;
- Të sigurohet se raportet janë komunikuar të gjitha departamenteve relevante, dhe janë analizuar dhe raportuar te menaxhmenti kryesor për të marr vendime;
- . Të kujdeset për transparencë të auditimeve duke i publikuar dokumentet e nevojshme;

- Të kryhen inspektime të jashtme duke përfshirë edhe vizitat e pa paralajmëruara në institucionet shëndetësore dhe vlerësimin e shërbimeve nga klientët dhe përfituesit;
- Të sigurohet komunikimi efikas i rezultateve;
- Të vazhdohet procesi i financimit të ofruesve të shërbimeve shëndetësore në bazë të performancës për të siguruar performancë më të mirë dhe përgjegjësi më të lartë;
- Të sigurohet zbatimi i Udhëzimit Administrativ për buxhetin dhe ekzekutimin e buxhetit për ofruesit e shërbimeve shëndetësore;
- Të sigurohet se lista e pritjeve është transparente me përditësime të rregullta (pacientët në listë të pritjes duhet të njihen me kode);
- Të paraqitet monitorimi i vendimeve për caktimin e prioriteteve në listë të pritjes;

### 3.1. *Përmirësimi i procedurave të licencimit dhe regjistrimit*

- Të sigurohet regjistrimi dhe procedurat përmes faqes zyrtare;
- Të kërkohet që stafi i përfshirë në procedura të regjistrimit dhe licencimit të nënshkruajnë dokumentin për konflikt të interesit që duhet të shpërndalet publikisht;
- Të sigurohet një proces për raportim dhe shqyrtim të konfliktit të interesit dhe të përcaktohet se cilat hapa duhet të ndërmerren. Një proces i tillë duhet të siguroj se individët me konflikte të vërteta apo të dukshme të interesit nuk përfshihen në vendimmarrje;

### 3.2. *Të forcohet mbikëqyrja e furnizimit me barna: prokurimi dhe distribuimi*

- Të monitorohet sistematikisht dhe periodikisht legjislacioni për barna për tu ballafaquar në mënyrë efikase me dobësitë e vërejtura, bazuar nga raportet dhe të gjeturat e auditimit të jashtëm dhe brendshëm;
- Të sigurohet funksionimi efikas i sistemit të menaxhimit të barnave përmes Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale;

- Të sigurohet zbatimi i politikave të dobishme për kushtet e blerjes së produkteve farmaceutike, duke krahasuar çmimet me praktikat e mira të shteteve tjera bazuar në standardet ndërkombëtare;
- Të para-kualifikohen furnizuesit (p.sh. përmes Programit para-kualifikues të OBSH/WHO) që ndihmon rritjen e mundësisë që furnizuesit të jenë të besueshëm;
- Të përfshihen grupet e shoqërisë civile në monitorimin e sistemit të furnizimit të barnave;
- Të miratohet Rregullorja mbi marrëdhëniet në mes të mjekëve dhe kompanive farmaceutike dhe komunikimi i tyre, gjithashtu edhe udhëzimi dhe porositë klinike;

### **3.3. Ndërtimi dhe forcimi i kontrollit operativ të integritetit në Fondin e sigurimeve shëndetësore**

- Të mbështetet miratimi i Kodit të etikës për punëtorët e Fondit të sigurimit shëndetësor;
- Të sigurohet reforma e financimit shëndetësor që është mishëruar në parimet e qeverisjes së mirë, transparencë, llogaridhënia dhe përgjegjësia për rezultate përmes kontrolleve të përshtatshme dhe masave të mbikëqyrjes, (auditimeve financiare, kontrollit të kualitetit);
- Të mbështetet ndërtimi i kapaciteteve të stafit të posa themeluar të Fondit të sigurimeve shëndetësore (FSSH) me përqendrim të posaçëm në menaxhmentin e rrezikut të integritetit;

### **3.4. Të rritet efikasiteti i sistemit të trajnimeve dhe zhvillimit profesional në MSh**

- Të paraqitet një sistem i besueshëm i Analizës për nevojat për trajnim me qëllim të përcaktimit të nevojave reale për trajnime;
- Të zgjerohet formati i trajnimeve duke u fokusuar në praktikë, sidomos për profesionistët të specializuar, të shikohet mundësia e shkëmbimit të eksperiencave nga praktika dhe mësimi i bazuar në eksperiencë;
- Të merren parasysh kurset specifike të menaxhimit të integritetit për menaxhmentin e mesëm dhe të lartë. Të shfrytëzohen kapacitetet e Institutit të Administratës Publike të Kosovës IKAP sa i përket trajnimit të përgjithshëm të menaxhmentit;
- Të mbështetet zhvillimi i programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për infermieret dhe mjekët. Të merret parasysh të hartohet programi arsimor i ri me fokus kryesor në marrëdhëniet mjek / infermiere - pacient;

### **3.5. Të forcohen mekanizmat e komunikimit të MSh me të gjitha grupet e interesuara si dhe të promovohet transparenca si mjet kryesor për ngritjen e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes së jashtme**

- Të sigurohen konsultimet me pjesëmarrës të jashtëm për krijimin e kornizës normative relevante;
- Përdorja e kanaleve pro aktive të shpërndara për të inkurajuar pjesëmarrjen, përfshirë edhe postimin e draft-akteve në faqen zyrtare, inicimin e diskutimeve publike, forumet të bazuara në rrjetin elektronik;
- Të rritet transparenca në përgatitje, duke ndërruar dhe ndryshuar ligje, përfshirë edhe grupet e fokusit;
- Të forcohet aspektet e integritetit duke zbatuar strategjinë e komunikimit duke ofruar informacione për të gjithë me qëllim të promovimit të arriturave të MSh-sa i përket reformave të integritetit;

- Të shpërndahen kanalet e komunikimit në lidhje me komunikimin e kërkesave të integritetit, kampanjat e vetëdijesimit së informatave të integritetit;
- Të vendoset vija telefonike e siguruar kundër korrupsionit për qytetar dhe profesionistë për ti ofruar pjesëmarrësve një kanal të besueshëm ku mund të paraqesin shkelje të integritetit;
- Të sigurohet siguria e përdoruesve dhe integrimi i rezultateve në sistemin menaxhues;
- Të sigurohet palëve informatat e mjaftueshme, të sakta, dhe lehtë të përdorshme që ti ju mundësohet të kryejnë obligimet;
- Të sigurohet monitorimi i zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente zyrtare;

### **3.6. *Promovimi i transparencës dhe involvimi i qytetarëve me qëllim të krijimit të bazës për kontroll të drejtpërdrejtë social.***

- Të zhvillohen, kampanjat dhe strategjitë e organizatave të pacientëve, për të ngritur vetëdijesim dhe për ti motivuar pacientët të raportojnë korrupsionin në sektorin e shëndetësisë;
- Përfshirja e qytetarëve “si mbikëqyrës i vazhdueshëm” i të mirave publike ;
- Të zhvillohet, programi edukues i pacientëve dhe i Organizatës së pacientëve, sidomos për ti vërtetuar të drejtat e tyre;
- Të zhvillohet dhe zbatohet Programi i gjerë i integritetit në mes të MSh dhe OJQ-ve që janë aktive në fushën e kundër korrupsionit dhe të shëndetësisë;

### **3.7. *Ngritja e përkushtimit ndaj sektorit privat***

- Të ngiten mekanizmat e konsultimeve me *sektorin privat*, duke përfshirë takime periodike konsultative të nivelit të lartë;

*Objektiva strategjike IV: Mbështetja e kulturës së integritetit në të gjithë sektorin e shëndetësisë së Kosovës*

Qeverisja e mirë kërkon vlerësim të plotë, vlerësime të qarta të masave që e promovojnë integritetin dhe e parandalojnë keqpërdorimet dhe korrupsionin. Prandaj, është qenësore që MSh të largohet nga përshkrimet e përgjithshme dhe statike se çfarë dhe cilat masa janë zbatuar apo jo. Vëmendja duhet të përqendrohet kah shënimet dhe standardet të cilat mbajnë njohuri faktike për funksionimin dhe ndikimin e këtyre planeve dhe veprimeve dhe e lejojnë transferimin e praktikave të mira. Gjatë kohës, këto shënime mund të përdoren për të ndjekur orientimet dhe ti mundësoj hartuesve të politikave dhe zyrtarëve publik që të vlerësojnë ndikimet dhe rezultatet që janë arritur dhe të identifikohen veprimet të cilat duhet ndërruar për të ec para. Për të arritur qëllimet e mësipërme, janë paraparë këto masa.

- Të zhvillohet qasja sistematike për monitorim, vlerësim dhe komunikim të brendshëm
- Publikimi i rezultateve të zbatimit të masave të integritetit, përfshirë publikimin e masave në raportin vjetor të menaxhmentit;
- Të forcohet implementimi i kornizës ligjore relevante që ka të bëjë me integritetin me shqyrtime periodike, me monitorim të implementimit, me analiza të zbrazësive të implementimit dhe me identifikimin e mundësive për përmirësim;
- Të përdoret maksimalisht potenciali i OJQ dhe i pjesëmarrësve tjerë për të prodhuar rezultate të rëndësishme në lidhje me ndikimin e reformave të integritetit;
- Të merret parasysh krijimi i rrjetës së integritetit në sektorin e shëndetësisë për të mbështetur shkëmbimin e informatave dhe eksperiencave dhe për të ndërtuar përkushtim kolekti;

**PLANI I VEPRIMIT**

*Objektiva strategjike I*

*Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit përmes zbatimit të kornizës strategjike relevante mbi integritetin*

Aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Bartës i kostos	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Departamenti përgjegjës
Integrimi i pikave potenciale kundër korrupsionit në Planin zhvillimor institucional të Ministrisë së Shëndetësisë	Numri i pikave të përcaktuara	K3 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor

Njoftimi i stafit me mekanizmat mbikëqyrëse në MSH	Numri i personelit të njoftuar me mekanizmat	K2 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave Divizioni i personelit
Caktimi i personit përgjegjës për të mbikëqyrë dhe raportuar zbatimin e Planit të integritetit	Personi përgjegjës i caktuar	K2 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Zyra e Sekretarit të përgjithshëm
Integrimi i qasjes kundër korrupsionit në Strategjinë Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale shëndetësore 2017-2021	Plani i integritetit i inkorporuar në planin e veprimit të SSSH 2017-2021	K2 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor

Hartimi i procedurave për ngritjen e përgjegjësisë, transparencës përmes komunikimit brenda ministrisë	Procedurat e hartuara	K3 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Divizioni i Informimit
Informimi për qasjen gjithëpërfshirëse kundër korrupsion duke promovuar dhe mundësuar zbatimin e planit të integritetit në tërë sektorin e shëndetësisë	Numri i broshurave të hartuara dhe shpërndara në ISH	K1 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Divizioni i Informimit
Zbatimit të masave të integritetit nga brenda, përfshirë edhe botime të raporteve për masat e integritetit si pjesë e raporteve vjetore të menaxhmentit	Numri i raporteve të publikuara	K4 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor

<p>Monitorimi i jashtëm dhe mbikëqyrja e zbatimit të masave, përfshirë edhe ato nga qytetarët, OJQ-ve, etj. Të sigurohet se rezultatet janë në dispozicion për publikun.</p>	<p>Numri i lëndëve të ofruara, takimeve me qytetar dhe komunikata ve</p>	<p>2018-2020</p>	<p>MSh</p>	<p>Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021  Strategjia për Informim</p>	<p>Divizioni i Informimit;  Divizioni për të drejtat e qytetarëve; Komisioni për qasje në dokumente zyrtare</p>
<p>Zbatimi i Kodit të etikës përmes komunikimit efektiv me gjithë stafin duke raportuar, shkeljet e supozuara të integritetit</p>	<p>Numri i personelit i informuar për Kodin Etik;  Numri i rasteve të raportuara</p>	<p>2018-2020</p>	<p>MSh</p>	<p>Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021</p>	<p>Divizioni i Personelit; Zyrtari Përgjegjës</p>

<p>Forcimi i rregullave/praktikave në fushat kryesore të mbrojtjes së integritetit: Konflikti i interesit, deklarimet e pasurive, dhuratat</p>	<p>Numri i akteve që rregullojnë mbrojtjen e integritetit, personave të trajnuar; aktiviteteve informuese</p>	<p>2018-2020</p>	<p>MSh</p>	<p>Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;</p>	<p>Departamenti Ligjor; Divizioni i burimeve njerëzore Divizioni i Informimit</p>
--	---	------------------	------------	--	---

*Objektiva strategjike II*

*Ngritja e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës së të gjitha funksioneve të MSh-së*

<b>Aktivitetet</b>	<b>Indikatorët</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Bartës i kostos</b>	<b>Ndërlidhja me dokumentet strategjike</b>	<b>Departamenti përgjegjës</b>
Forcimi i kapaciteteve për menaxhim të integritetit	Numri i personave të trajnuar	2018-2020	DONATOR	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor Departamenti Financiar dhe i Shërbimeve të Përbashkëta
Ri-vlerësimi periodik i aktivitete të planit të integritetit	Numri i raporteve	K4-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor
Hartimi i planit të trajnimit për TQM për institucionet shëndetësore	Plani i trajnimit i hartuar;	K4-2019	DONATOR	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor

Vlerësimi i kënaqshmerisë së pacientëve	Numri i raporteve, dhe hulumtimeve të publikuara	K4 2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 Strategjia për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë;	Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore ; Divizioni i Cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve
Raportimi i rregullt i procesit të rekrutimit, përfshirë kriteret e transparencës	Numri i raporteve të hartuara	2018-2020	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021	Divizioni i burimeve njerëzore
Monitorimi i rregullores për avancim në karrierë në bazë të meritave	Numri i avancimeve të lëshuara;	2018-2020	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Divizioni i burimeve njerëzore
Rritja e transparencës në procesin e prokurimit në të gjitha fazat e tij duke vendosur standardet minimale për	Publikimi i kontratave të	2018-2020	MSh	Strategjia e Komunikimit të MSh-së	Divizioni i Prokurimit; Divizioni i Informimit

transparencë në MSH	nënshkruar a në Web faqe				
Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për zyrtarët e prokurimit	Numri i Zyrtarëve të trajnuar	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021; Plani Zhvillimor Institucional	Divizioni i Prokurimit; Divizioni i burimeve njerëzore
Përmirësimi i transparencës në procedurat e prokurimit, përfshirë shoqërinë civile, mediet ;	Numri i pjesëmarrësve të jashtëm në procedurat e prokurimit ( qytetarët dhe OJQ);	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Divizioni i Prokurimit; Divizioni i Informimit
Përpilimi i listës së kompanive që zotohen për zbatimin e	Lista e	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale	Divizioni i Prokurimit

rregullave të integritetit	hartuar			Shëndetësore 2017-2021;	
Përcaktimi i kriterëve për vlerësimin e kontraktorëve, bazuar në performancë	Kriteret e përcaktuara	2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Divizioni i Prokurimit
Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit	Numri i rekomandimeve të zbatuara;	2018-2020	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Zyra e Auditimit të brendshëm
Ngritja e kapaciteteve të auditimit dhe inspektimit	Numri i auditorëve të trajnuar;  Numri i inspektorëve të trajnuar	2018-2020	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Divizioni i adutimit të brendshëm;  Inspektorati shëndetësor

<p>Hartimi i procedurës së brendshme për dëshmitarët të cilët tregojnë për shkelje si mënyrë për të raportuar për korrupsionin e vërejtur apo ndonjë dyshim në lidhje me veprimet e dyshimta.</p>	<p>Procedura e hartuar</p>	<p>K3-2018</p>	<p>MSh</p>	<p>Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;</p>	<p>Departamenti Ligjor</p>
<p>Ngritja e vetëdijesimit të mekanizmave të brendshëm për ankesat kundër hierarkisë.</p>	<p>Numrit i rasteve të raportuara</p>	<p>2018-2019</p>	<p>MSh</p>	<p>Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;</p>	<p>Divizioni i Burimeve Njerëzore</p>

**Objektiva strategjike III**

**Forcimi i kontrolleve operative ndaj shkeljeve të integritetit në sektorin e shëndetësisë**

Aktivitetet	Indikatorët	Afati Kohor	Bartës i Kostos	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Departamenti përgjegjës
Të sigurohet që marrëveshjet me ofruesit e shërbimeve shëndetësore në sektorin e shëndetësisë, objektivat, rolet dhe përgjegjësitë të jenë qarta	Numri i Indikatorëve të zbatuara në Kontratat me ofruesit e shërbimeve	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
Hartimi i procedurave të monitorimit të	Procedurat e brendshme të	K4-2018	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Departamenti Financiar dhe i Shërbimeve të

brendshëm për ekzekutimin buxhetit	hartuara				Përbashkëta
Sigurimi i transparencës për listën e pacientëve që trajtohen jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	Numri i ankesave të shqyrtuara	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
Sigurimi i një procesi të qartë për raportim dhe shqyrtim të konfliktit të interesit	Numri i rasteve të shqyrtuara	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Ngritja e efikasitetit të sistemit të menaxhimit të barnave	Numri i raporteve për furnizim	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
Përfshirja e shoqërisë civile në monitorimin e çmimeve të barnave	Numri i aktiviteteve monitoruese	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore Divizioni i Farmacisë
Hartimi i Planit për nevojat për trajnim në Ministrinë e shëndetësisë	Plani i hartuar;	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Divizioni i Burimeve Njerëzore
Përpilimi i pyetësorëve për	Numri i trajnimeve të	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale	Divizioni i Burimeve

vlerësimin e trajnimeve	vlerësuara			Shëndetësore 2017-2021;	Njerëzore
Zbatimi i Planit të veprimit të Strategjisë së Komunikimit	Numri i aktiviteteve të zbatuara	2018-2019	MSh	Strategjia e Komunikimit	Divizioni i Informimit
Monitorimi dhe analizimi i ankesave kundër korrupsionit të raportuara përmes linjës telefonike	Numri i rasteve të raportuara	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021;	Inspektorati shëndetësor; Divizioni për liritë dhe të drejtat e njeriut
Mirëmbajtja dhe përditësimi i rregullt i informatave në faqen zyrtare të MSh-së	Numri i informatave të përditësuara	2018-2019	MSh	Strategjia e Informimit	Divizioni i Informimit

Zhvillimi i kampanjave me Shoqatën e pacientëve për ngritjen e vetëdijes për raportimin e rasteve të korrupsionit	Numri i kampanjave të zhvilluara	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021; Strategjia e Informimit	Divizioni i Cilësisë; Divizioni i Informimit
---	----------------------------------	-----------	-----	--	---

*Objektiva Strategjike IV*

*Mbështetja e kulturës së integritetit në të gjithë sektorin e shëndetësisë së Kosovës*

Aktivitetet	Indikatorët	Afati Kohor	Bartës i Kostos	Ndërlidhja me dokumentet strategjike	Departamenti përgjegjës
Monitorimi dhe vlerësimi i	Raporti i	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale e	Divizioni i Informimit

komunikimit të brendshëm	vlerësimin të komunikimit të brendshëm			Shëndetësisë 2017-2021; Strategjia e Informimit	
Publikimi i rezultateve të zbatimit të masave të integritetit, përfshirë raportin vjetor të menaxhmentit.	Raporti i publikuar	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021;	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
Krijimi i rrjetës së integritetit në sektorin e shëndetësisë për të mbështetur shkëmbimin e informatave dhe eksperiencave dhe për të ndërtuar përkushtim kolektiv	Numri i Institucioneve që zbatojnë Planin e Integritetit Institucional	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021;	Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor

Prezantimi i planit të integritetit institucional në sektorin privat	Numri i Institucioneve private shëndetësore të njoftuara me Planin e Integritetit	2018-2019	MSh	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021;	Divizioni për Licencim dhe Akreditim të institucioneve shëndetësore
--	---	-----------	-----	---	---